



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Numri i lëndës: 2023:077752

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05665530

CN.2023:077753

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL, GJYQTARJA Kreshnike Zymberi - Beqiri, me bashkëpunëtorin profesional Gent Mustafa, në çështjen kontestimore sipas padisë së propozuesit E.H. nga fshati ... -Komuna.... të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Visar Musa, me seli në Ferizaj në rr. “Driton Islami” pn, ndaj kundër propozuesës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Shpronësimit, me objekt kontesti shpërblimi i paluajtshmerisë së shpronësuar, jashtë seancës me datën 08 maj 2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

KONSTATOHET I TËRHEQUR – propozimi i propozuesit E.H.nga ....., të paraqitur ndaj kundërpropozueses Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Shpronësimit, me objekt kontesti shpërblimi i paluajtshmerisë së shpronësuar.

**A r s y e t i m**

Propozuesi E.H.nga ....., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Visar Musa, me datën 28.03.2023 në këtë gjykatë, ka parashtruar propozim për shpërblimin e paluajtshmerisë së shpronësuar, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti i Shpronësimit.

Gjykata me datën 26.03.2024, ka pranuar parashtresën e të autorizuarit të palës paditëse, me të cilën ka theksuar se e tërheqin propozimin pasi kjo çështje do të rregullohet në një procedurë tjetër dhe i ka propozuar gjykatës që të konsideroj të tërhequr propozimin.

Gjykata pas pranimit të parashtrësës për tërheqjen e propozimit, vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore që propozimi të konstatohet i tërhequr ashtu siç e para sheh neni 12 i LPJK-së, *“Propozimi me të cilin është inicuar procedura mund të tërhiqet derisa të jepet aktvendimi i shkallës së parë për zgjidhjen e çështjes. Propozimi i paraqitur nga disa persona tërhiqet me deklaratën e përbashkët të tyre, po qe se me ligj nuk është caktuar ndryshe.”*

Ndërsa në nenin 3 të LPJK-së përcaktohet se *“Në procedurën jokontestimore përshatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe.”*

Ndërsa në nenin 261 të LPK-së është përcaktuar se: *Po qe se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po qe se padia i është dorëzuar me parë. Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi.”*

Andaj, bazuar në të lartcekurat në nenin 3, 12 të LPJK-së, dhe 261 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

CN.2023:077753, me datë 08 maj 2024

Gjyqtarja  
Kreshnike Zymberi Beqiri

**KËSHILLË JURIDIKE** - Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa, ashtu siç parashihet në nenin 261 par 4 të LPK-së.